

VENDIM I GJYQTARIT TË VETËM

Sot, më datë 28 maj 2003, unë *(H. Lume)*, gjyqtare pranë kësaj gjykate, pasi studjova kërkesën dhe dokumentacionin e paraqitur nga z. James Reiff në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm të Shoqërisë PARTNERI SHQIPTAR NË MIKROKREDI SHA për depozitimin e akteve të personit juridik,

KONSTATOVA SE:

Shoqëria anonime PARTNERI SHQIPTAR NË MIKROKREDI SHA është person juridik i së drejtës shqiptare, regjistruar me Vendimin Nr. 25341, datë 2 mars 2001 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, me seli në adresën Rruga "Gjin Bue Shpata", Nr. 7/1, Tiranë dhe me aksionerë: 1) shoqërinë Opportunity Microcredit Fund (Eastern Europe), shoqëri e krijuar në bazë të ligjeve të Anglisë dhe Uellsit, e themeluar më 24 Shkurt 1998 me Numër regjistri 3516266; dhe 2) shoqërinë Opportunity Transformation Investments Inc. shoqëri e krijuar në bazë të ligjeve të Illinois, e themeluar më 19 Qershor 2000.

Më datë 4 Maj 2003 është zhvilluar mbledhja e Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve të shoqërisë PARTNERI SHQIPTAR NE MIKROKREDI SHA, e cila ka vendosur:

1. Të zvogëlojë kapitalin aksioner të shoqërisë PARTNERI SHQIPTAR NE MIKROKREDI SHA me shumën Lekë 15,210,216 (pesëmbëdhjetë milion e dyqind e dhjetë mijë e dyqind e gjashtëmbëdhjetë) për të mbuluar humbjet e viteve të mëparshme financiare në përputhje me Raportin e Ekspertit Kontabël të Autorizuar të Shoqërisë Z. Limoz Malaj.
Me zvogëlimin e kapitalit shuma e përgjithshme e kapitalit aksioner të shoqërisë do të jetë në shumën Lekë 446,881,606 (katërqind e dyzetë e gjashtë milion e tetëqind e tetëdhjetë e një mijë e gjashtëqind e gjashtë).
2. Të zëvendësojë Z. William Reichard i cili ka hequr dorë nga detyra e anëtarit të Këshilli Mbikqyrës me Z. Altin Naqe, shtetas shqiptar, lindur më 27 shkurt 1972, në Përmet, banues në Tiranë, mbajtës i pasaportës nr. 0547523.

PËR KËTO ARSYE:

Pas shqyrtimit të kërkesës, e çmoj atë të mbështetur në ligjin Nr. 7638, 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare" dhe Ligjin Nr. 7667, datë 28.01.1993 "Për regjistrin tregtar dhe formalitetet që duhen respektuar nga shoqëritë tregtare",

VENDOSA:

- Pranimin e Kërkesës;
- Depozitimin e Vendimit të Asamblesë së Jashtëzakonshme të shoqërisë PARTNERI SHQIPTAR NË MIKROKREDI SHA të datës 4 maj 2003 e cila ka miratuar:

1. zvogëlimin e kapitalit aksioner të shoqërisë PARTNERI SHQIPTAR NE MIKROKREDI SHA me shumën Lekë 15,210,216 (pesëmbëdhjetë milion e dyqind e dhjetë mijë e dyqind e gjashtëmbëdhjetë) për të mbuluar humbjet e viteve të mëparshme financiare në përputhje me Raportin e Ekspertit Kontabël të Autorizuar të Shoqërisë Z. Limoz Malaj.
Me zvogëlimin e kapitalit shuma e përgjithshme e kapitalit aksioner të shoqërisë do të jetë në shumën Lekë 446,881,606 (katërqind e dyzetë e gjashtë milion e tetëqind e tetëdhjetë e një mijë e gjashtëqind e gjashtë).
 2. zëvendësimin e Z. William Reichard i cili ka hequr dorë nga detyra e anëtarit të Këshilli Mbikqyrës me Z. Altin Naqe, shtetas shqiptar, lindur më 27 shkurt 1972, në Përmet, banues në Tiranë, mbajtës i pasaportës nr. 0547523.
- Urdhërohet zyra e Regjistrat Tregtar të bëjë pasqyrimin e ndryshimeve në skedën përkatëse të shoqërisë.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit.

GJYQTARE
